

BARDHYL DEMIRAJ

## Grimca biografike për autorët tanë të vjetër

### II. Andrea Bogdani (1607 – 1683)

#### 1. Fjalë hyrëse

Kush mëton të ketë lexuar a dëgjuar sado përciptas emrin e Imzot Andrea Bogdanit në historinë e kulturës së shkrimit shqip, në mos edhe në atë ekleziastike të Kishës Katolike Romake në trevat shqipfolëse, vështirë t'i ketë anashkaluar dot emrit të të nipit, shi Imzot Pjetër Bogdanit, si: "mâ i vlerti ndër shkrimtarët e hershëm të shqipes." (Rrota 1941 46) Rrethana të tilla paralele në marrëdhëniet *nip : ungj* i hasim jo rrallë në këto vise e ato shtresa sociale përgjatë shek. XVII-XVIII. Mjafton të përmendim këtu thukët do emra dyersh arbënore si p.sh. Dera e Bardhenjve në zonën e Zadrimës (me Frang e Gjergj/Gjec Bardhin etj.), Dera e Radovanëve në Shirokë apo ajo e Vladanjëve në Shkodër etj., të cilat kanë nxjerrë me shumicë e në vazhdimësi barinj shpirtërorë në Provincën Kishtare të Arbënisë e në Arqipeshkëvinë e Shkupit. Asgjëmangut kemi të bëjmë – në rastin më të debatueshëm (!!!) – me shembuj "nepotizmi" pozitiv, kur gjakuesit i bashkon me njëri-tjetrit, me i dhënë dorë njëri-tjetrit, më fort se sa lisi i gjakut, bash ajo aortë e përbashkët që përthith Thirrjen Hyjnore, nxit edukimin shpirtëror dhe orienton formimin meshtarak-intelektual përkatës, duke mundësuar më pas rrugëtimin e mundimshëm baritor në mbarështimin e grigjës së besimtarëve, e përkujdesur sipas kohës e rastit angazhimin e mirëfilltë diturak pranë asaj aradhe intelektualësh, ku mendojnë se bëjnë pjesë së bashku.

Andrea Bogdani, me saktë Ndreu ynë, është padyshim njëri syresh, anipse sot e gjithë ditën nuk mund ta vlerësojmë ndryshe, veçse si axhamadhin e ulur këmbëkryq nën hijen e të nipit, Pjetrit të Madh të Derës së Bogdanajve farëmirë. Dhe është fakt, që të vetmin kumt, sado domethënës, lidhur me angazhimin e tij intelektual në kulturën e shkrimit shqip, sikurse edhe në debatin albanologjik të kohës e ngjërojmë ashtu fshehur mes rreshtash të "Çeta e Profetëve" (Padova 1685), bash në hyrjen: "Të primitë para letërarit", ku Pjetri ynë mëngon të na mësojë, ndër të tjera:

[/f. XV] Për njëzet e një vjet, mbasi bajta barrën' e upeshkëpīs' Shkodërsë e kujdesn' e Tivarit dhanunë nd' aministracione, kjeshë prej shëjtit atë Papë Inoçenti XI vjetit 1677 bam argjupeshkëpi i Shkupsë e aministratori i gjithë regjënīsë Shërbīsë, për të lutuna të fort ndrçimit e fort ndershimit tim zot pomendunë për nder, Andre Bogdanit, tim ungi, i silli ma para kje argjupeshkëpi i Ohërit, ani bam argjupeshkëpi i Shkupsë e i dheut Shërbīsë, ashtu qi t i gjindeshe afërë ndë mort ndihmëtar, tue mos kjanë ma i zoti me ju pruem atë kërshtenimi, përse kishte për pleqënī kapërcyem 80 vjet ndë lëngime të forta. Ky zot fort i urtë më dha fort zemërë me votë paret ndë këtë vepërë, ende tue më ndimuem pakuer fort ndë shumë fjalë t'arbënesha, të siatë i kish udob e për duer, tue pasunë bam ende aj një gramatikë fort të godiçime latin e shqip. Ma mbasi dviq 13 dit ndë deçembre [f. XVI] 1683, m u desh mue ndëpër punë të ushtërīsë ndënë Beçit, shumë herë me ngrehunë e me çkrehunë librarinë teme, tue jau porositunë kjorevet, gozhduem arkëvet e lidhunë thasëvet, e tue ikunë malevet, aqa sa gramatika ndë këto të përzieme ntreti si krypa nd'ujët./ (tejskruar prej Omarit 2005 *loc. cit.*)<sup>1</sup>

Befasohemi kështu me një rast aspak rastësor në historinë e kulturës së shkrimit shqip, kur dorëshkrime, madje edhe botime të hershme shqip ase sosh mbi gjuhën shqipe kanë përjetuar ndeshtrashat vrastare të moteve, duke u tretur përfundimisht, në mos – në rastin më fatlum (!!!) – gjëlljnë struktur e pluhurosur sot e gjithë ditën diku në ndonjë arkiv a bibliotekë tinëzare në dhe të huaj, në mos edhe në dhe të Arbënit. Por jo vetëm kaq: përballemi edhe me një dukuri të dytë e po ashtu aspak rastësore, sa u përket botimeve të sotme enciklopedike në hapësirën shqipfolëse, ku këta humbësia të mëdhenj ndajnë me njëri-tjetrin të njëjtin fat të pafat: nuk gëzojnë një zë sado të vockël të vetin në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (Tiranë 1985<sup>1</sup>; e për rrjedhojë edhe në FESH Tiranë 2008/9<sup>2</sup>). Këmbëngulim fort në këtë detaj, sado i ashpër e mizor që mund t'u feksë e tingëllojë sot syve e veshëve tanë, sepse pas gjase kemi të bëjmë me një kriter seleksionues sa të pandërgjegjshëm, aq edhe metodik që përkon jo rastësisht me – thënë më saktë: vijon në kohën tonë thjesht dhe vetëm për inerci të fatit – atë kriter dikur seleksionues sa të papërgjegjshëm, aq edhe ideologjik ndaj elitës së mëhershme të kulturës shpirtërore, e për rrjedhojë edhe të mendimit intelektual-albanologjik shqiptar në shek. XV-XX, kur kjo elitë mbartte

<sup>1</sup> Autori dëshëron t'i shprehë falënderimet e rastit koleges Anila Omari (QSA Tiranë), e cila e lejoi që të përdorë në citatet përkatëse tejskrimin e veprës së Pjetër Bogdanit, të realizuar prej saj: Omari 2005.

në shumësinë e rasteve zhgunin e fratit ase veladonin e priftit në trojet po-shqiptare.<sup>2</sup>

Rreshtuam në këto fjalë hyrëse arsyet që na joshën të ndërmarrim një portretizim sado të brishtë të Imzot Andrea Bogdanit, thënë më saktë Ndreut tonë, me shpresën dhe dëshirën e mirë që edhe atij sikurse shumë e shumë vëllamëve të vet t'u bëhet dikur vend në botimet e ardhshme enciklopedike të kulturës shqiptare, ku mund e duhet të ngërthehet në detaj e doemos historia ekleziastike e trevave shqipfolëse si pjesë përbërëse e matriksit të kulturës etnike gjithëshqiptare në kohë e hapësirë. Shtojmë gjithashtu se këtë portretizimin e konsiderojmë më fort si nxitje për studime të thelluara në të ardhmen. Prashtu nuk kemi synuar këtu aspak një vjelje ballore të burimeve arkivore e të shumësisë së atyre prurjeve sado anësore në letërsinë shkencore të kohës. Një hetim i bërë në ato përmasa sigurisht që do të kapërcente jo vetëm mundësitë praktike, por edhe kapacitetet intelektuale të shkruarit të këtyre radhëve. Andaj jemi mjaftuar në këtë shkrim kryesisht në krehjen dhe përpunimin e do burimeve të dorës së parë, siç janë, përpos atij materiali arkivor që kemi mundur të qëmtojmë në Arkivin Historik të Shtëpisë së Shenjtë në Loreto (= ASSC – maj 2015) dhe në Arkivin Roman të Shoqërisë së Jezusit në Romë (= ARSI – mars 2015), edhe ato përshkrime të bëra nga vetë dora e të nipit, Pjetrit, disa muaj pas ndarjes së Ndreut tonë nga jeta, si edhe ndonjë pasqyrim sado të thukët mbi aktivitetin e tij baritor në kompendiumet enciklopedike të historisë ekleziastike në Ballkanin Perëndimor (Farlati & Coletti: *Illyricum Sacrum*, bl. VIII), ose syresh që janë ndërmarrë kryesisht në disa studime të thelluara mbi figurën dhe personalitetin e Pjetër Bogdanit. (Marlekaj 1989, 2008<sup>2</sup>; Gjini 1992; Marquet 1996 etj.)

## 2. Të dhëna biografike mbi Andrea Bogdanin

Si i nipi ashtu edhe i ungji, e si të tillë gjithë paraardhësit e vet, trangu i të cilëve zbritka – pa dale-dale!!! – deri në motet e lavdishme të sundimit të Stefan Nemanjës, mbret i Serbisë (1167 – 1196), i cili nuk e paska lënë pa shpërblyer sa e siç duhet as familjen atëbotë fisnike dhe besnike të Bogdanajve, duke i dhuruar asaj prona të patundshme që ngërthenin një hapësirë assesi të vogël: prej *Hekurit* (si toponim popullor, kundrejt zyrtarit *Samokovo* – ?) e deri në Shkup në rrjedhën Vardarit. Këtë *Mot të Madh* e përjetoi Dera e Bogdanajve pas gjase deri në kohën e Sulltan Muratit II, kur një degë të saj e gjëllinte në brigjet e Danubit, në qytetin fortesë Samandria të Serbisë. Këtë na e mëson Pjetër Bogdani dora vetë, kur ndalet në pasthënien e opusit të tij te

<sup>2</sup> Për dukurinë e shpëlarjes së kujtesës dhe pasojat e saj në periudhën e tranzicionit intelektual që përjeton ndërkohë inteligenca shqiptare, shih së fundi Demiraj 2016.

“Pleqënia e Shtëpisë Bogdanjet”, duke kumtuar ndër të tjera:

/Perendori Shtjefënë shtëpijet së Nemanjet, dau dhën’ e vet qefalijvet vetë ma t’ fëshimet e për besë e për vërtyt; atë anë qi prej Hekurit (sod thanunë Samokovo) e çtrihetë ndjerë mb’ ujë të Asit, sod Vardarit, i silli rrjedh për mjedist Shkupsë, e dha Bogdanit, nieri i dërejtë, posi thotë *Marino Urbini de Regno Slavo foglio 267*. | E njimenda shtëpī e Bogdananjet ndoq ende tue urdhënuem ndjerë mbë rend të Sultan Muratit dyjtë, tue bajtunë barrën’ qehajesë Despotit Shërbīsë, qi aso koheje rrij ndë Sëmendrēt. [...]/ (Tejshkrimi Omari 2005)

Sado i besueshëm u dukte a tingëlloftë sot në sytë e veshët tanë ky kumt, asgjë nuk i ndryshon sadopak statusit pas gjase tejet modest të familjes, ku lindi dhe kaloi fëmëninë e vet Ndreu ynë, një djalosh paksa i sertë dhe i pabindur ndaj të parëve, të paktën ashtu siç na e përshkruan i nipi në një shkrim të natyrës nekrologjike që i dërgon Kongregacionit të Shenjtë më 2 prill 1684, pra disa muaj pasi Ndreu ishte ndarë nga jeta, khs.:

Dëshmia (1): [Shqip – B.D.]

“Ndre Bogdani, biri i Gjonit nga Gjonaj (?) i Dioqezës së Prizrenit në kufi me Serbinë dhe Arbëninë. Lindi më 1600 [sic!]; duke qenë në moshën 25 vjeç e kundër lejes së prindërve filloi të studiojë bazat fillestare për t’u bërë prift për t’i shërbyer atdheut, i cili me dyndjen e madhe të osmanëve po precipitonte drejt afetarisë. Duke qenë i shtyrë në moshë shkoi dy herë në këmbë për pelegrinazh në Loreto për t’u pranuar në kolegji, ku më së fundi u pranua, pasi drejtuesit ‘vunë oroe atë vokacion aq të zjarrtë [...]’ Këtu, brenda një hapësire kohore prej 6 vjetësh, përfitoi në një mënyrë të tillë, të menjëhershme moralin, përkushtimin ndaj Zotit dhe karizmën e krishterë, duke u shuguruar prift me ...”<sup>3</sup>

<sup>3</sup> ASPF SC Servia 1669-1760, vol. 1 ff° 131r-134r; 134v – botuar si faksimile te Marlekaj (1989) 2008<sup>2</sup> 621vv. e tejshkuar te Marquet 1996 426vv. (dok. 255): (teksti origjinal) <Andrea Bogdani figlio di Giovanni da Giannani della Diocesi di Prisreno nelli confini di Servia et Albania. Nato delli 1600 pervenuto, che fu all’anno 25 della sua età, contra il voto de parenti principio a studiare li primi elementi a fine di farsi Sacerdote per sovenire la sua Patria, che per la gravosa contributione a Turchi stava per precipitare nella infedeltà. Essendo spinto nell’età doi volte a piedi da pellegrino andò a Loreto per esser ammesso nel Collegio, ove finalmente vedendo li Superiori una vocatione tanto ardente con dispensa della Bolla dell’eretione fu ammesso. Qui per spatio di sei anni s’approfittò a modo tale nella Morale, Pietà e Carità christiana, che fu fatto Sacerdote, con applauso della sua simplicità e rettitudine indicibile.[...]>

## 2.1. Vendi dhe viti i lindjes (Gjonaj më 1600 ?)

Me këtë pasazh të dytë hapim edhe hetimin tonë lidhur me të dhënat biografike kryesore të Ndre Bogdanit, siç janë atësia: biri i Gjonit (= it. <Gioanni>), sikurse edhe vendlindja, ngulimi <Giannani>, i cili, duke qenë atëbotë nën juridiksionin administrativ kishtar të Dioqezës së Prizrenit, na lejon ta identifikojmë me pak a shumë siguri me fshatin e sotëm Gjonaj në zonën e Hasit.<sup>4</sup> Problem më të madh përcjell gjithsesi ky kumt sa i përket vitlindjes së Ndreut tonë, për të cilin i nipi na mëton motin 1600. Pas gjase kemi të bëjmë në këtë rast – thënë me lezet! – me një farë rumbullakosje nga poshtë-lart, çka ndodh jo rrallë me Pjetër Bogdanin, madje sidomos edhe kur mëton vitlindjen e vet, e cila sipas kohës dhe rastit shtëmangjet ndërmjet viteve 1618 deri më 1630.<sup>5</sup> Siç do të konkludojmë më poshtë, përlllogaritjet që lejohemi të bëjmë sipas të dhënave që fitojmë prej dokumentacionit shumë më të besueshëm në Kolegjin Ilirik të Loretos na lejojnë ta xhvendosim vitlindjen e tij me shtatë mote më shumë, pra aty te viti 1607.

## 2.2. Rinia dhe edukimi në Kolegjin Ilirik të Loretos (1631-1639)

Vijmë kështu natyrshëm në çështjen e dytë që duam të hetojmë në lidhje me biografinë e Ndreut tonë, i cili sipas Pjetër Bogdanit nuk iu bind aspak prindërve dhe pa një e pa dy ndërmori vetë nismën për të bërë karrierë baritore, madje në një moshë aspak të favorshme për t'u pranuar në një kolegji fetar. Prashtu ky vullnet i hekurt e bëri të merrte dy herë rrugën e vështirë të pelegrinazhit drejt Shtëpisë së Shenjtë në Loreto (Shteti Papnor/Itali), duke arritur vetëm në këtë mënyrë të bindë përfundimisht instancat përkatëse si një i ri në moshë të pjekur që jes në mish e në shpirt me Thirrjen Hyjnore. Më shumë detaje lidhur me periudhën e studimit të tij në Kolegjin Ilirik të Loretos i mësojmë në njërin ndër dokumentacionet e depozituara në ASSC, ku ndër të tjera lexojmë:

Dëshmia (2): [Shqip – B.D.]

“Ndre Bogdani prej fshatit Gjonaj në Dioqezën e Prizrenit në moshën 24 vjeç; hyri në Kolegjin Ilirik të Loreto-s më 6 gusht 1631 me urdhër të Kongregacionit të Shenjtë të Propagande Fide-s, duke qenë i shtuar mbi numrin e zakonshëm [të rishtarëve]. U largua me lejën e Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s më 10 shtator 1636. Arqipeshvi i Ohrit.”<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Shkruesi i këtyre radhëve i bashkohet kështu mendimit të dhënë prej kolegut dhe mikut të vet, Rexhep Ismajlit (korrespondencë).

<sup>5</sup> Shih ndër të tjerë Marlekaj 2008<sup>2</sup> 9vv.

<sup>6</sup> ASSC Loreto: Tit XXX fasc. 2: /Nomi, Cognomi, Patria, entrata e partenza de gl'Aluni et ordinari sacri/ fol. 4v: (teksti origjinal) <Andrea Bogdani de Pago Gianani della Dio[esi] di

Kësaj dëshmie i paraprin në katalogun përkatës një shënim shtesë:

Dëshmia (3): [Shqip – B.D.]

“Për ushqimin e dy rishtarëve shqiptarë: Pal Bardhi dhe Ndre Bogdani merren nga Kongregacioni i Propaganda Fide-s katër herë në vit nga 36 scuda në fund të çdo tremujori dhe në fund të nëntorit të këtij viti 1635 duhen për tremujorin e ardhshëm.”<sup>7</sup>

Në katalogun në fjalë është përfshirë në fund edhe një rubrikë të veçantë: “Nomi dell’Alunni che si sono Ordinati mentre stavan nel Coll.º Illyrico”, ku janë rrokur për periudhën në shqyrtim të gjithë emrat e atyre rishtarëve në kolegji që kishin mundur të mbyllin studimet me sukses, duke gëzuar kështu edhe shugurimin përkatës priftëror, khs.:

Dëshmia (4): [Shqip – B.D.]

“Ndre Bogdani shqiptar mori më 22 dhjetor 1635 të gjithë urdhërat e vegjël në Recanati prej Imz. Amico Panico, ipeshkëv i Recanati-t dhe Loreto-s. I njëjti Ndre mori statusin e nëndiakonit prej të njëjtit imzot në të njëjtin qytet të Recanati-t më 27 dhjetor të të njëjtit vit 1635. I njëjti Ndre mori statusin e diakonit prej të njëjtit imzot në të njëjtin qytet më 30 dhjetor të të njëjtit vit 1635. I njëjti Ndre mori shugurimin e priftit prej të njëjtit imzot në macerata më 20 janar 1636.”<sup>8</sup>

Këtyre tri dëshmime të qëmtuara prej nesh në ASSC në Loreto,<sup>9</sup> mund t’u shtojmë tash edhe një të fundit, që kërkuam e gjetëm dikur në ARSI, ku është i depozituar libri i betimeve të para të rishtarëve të këtij kolegji, pasi kishin përfunduar zakonisht me sukses lëndën e gramatikës si shkallë e parë formimit akademik-fetar<sup>10</sup>: “Liber in

---

Preseren di anni 24. Entrò in Coll[egi]o Ilirico in Loreto li 6 Aug. 1631, per ordine della Sacra Congr[egatio]ne de Propaganda Fide, essendo entrato sopra il numero ordinario. Parti con licenza della S[acra] Congr[egatione] de Prop[aganda] Fide alli 10 di 7bre 1636. Arciues[cou]o Ocridentis.>

<sup>7</sup> ASSC Loreto: Tit XXX fasc. 2, fol. 1r: (teksti origjinal) <Per l’Alimenti di due Albanesi: Pavlo Bianchi et Andre Bogdan se riceuono dalla Congregazione de Propaganda Fide 4 volte l’anno scudi 36 al fine d’ogni trimestre ed al fine di nov[embre] di quest anno 1635 si devono per il trimestre futuro.>

<sup>8</sup> ASSC Loreto: Tit XXX fasc. 2, fol. 51r: (teksti origjinal) <Andrea Bogdan Albanese alli 22. di Xbre 1635 prese tutti gli ordini minori in Recanati da Monsig[no]re Amico Panico Vescovo di Recanati, e Loreto. L’istesso Andrea prese il Subdiaconato dall’istesso Monsig[no]re nell’istessa Citta di Recanati alli 27. di Xbre dell’istesso anno 1635. L’istesso Andrea prese il Diaconato dall’istesso Monsig[no]re nell’istessa Citta adi 30 di Xbre dell’istesso anno 1635. L’istesso D. Andrea prese il Sacerdotio dall’istesso Monsig[no]re in Macerata adi 20 Gennaro 1636.>

<sup>9</sup> Shih edhe Jurić & Korade 1983 75, 171.

<sup>10</sup> Kemi të bëjmë me fazën e parë të formimit akademik sipas programit të mirënjohur *Ratio*

quo habentur Nomina Alumnorum qui in Coll.o Illyrico Laurentano praestiterunt Juramentu. Ab Anno D.ni MDCXXVIII & Princeps & nomina rectori Collegii", khs.:

Dëshmia (5):

*Shqip:* "Më 25 mars 1632 Ndre Gjon Bogdani, Dioqeza e Prizrenit."<sup>11</sup>

### **Vëzhgime paraprake:**

Këto dëshmi që paraqitëm të tejshkruara më lart, përcjellin një numër të dhënash më se të besueshme biografike, sa u përket kohës së qëndrimit dhe formimit fetar-intelektual të Ndre Bogdanit në Loreto, ndër të tjera:

- Ndreu u pranua në Kolegj me ndërhyrje të posaçme të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s, i cili i siguroi një vend shtesë në Kolegjin Ilirik të Loretos, duke paguar vetëm për ushqim në çdo tremujor një shumë atëbotë aspak të vogël në plot 36 scuda.
- Falë kësaj ndërhyrjeje Ndreu u regjistrua në kolegj më dt. 6 gusht 1631 në moshën 24 vjeç, një moshë kjo aspak e zakonshme për rishtarët që pranoheshin aty zakonisht në moshat 14 deri 17 vjeç. Gjithsesi na mjafton mirëfilli kjo e dhënë për të përllogaritur dhe saktësuar vitlindjen e Ndreut që përkon me vitin 1607.<sup>12</sup>
- Pas marrjes së mësimave të para (pas gjase në lëndët e gramatikës: gjuhët italisht dhe latinisht) Ndreu bëri betimin pranues në kolegj, duke premtuar një studim të suksesshëm, besnikëri ndaj Thirrjes Hyjnore e se pas përfundimit të studimeve do të kthehej në vendlindje, duke iu bindur aty vendimeve që do të merrte Ipeshkvi lidhur me aktivitetin e tij meshtarak.
- Në fund të studimeve në kolegj, Ndreu ngadhënjen në një periudhë fare të shkurtër urdhërat dhe shkallët e para të karrierës meshtarake, duke u shuguruar prift më 20 janar 1636.
- Ndreu nisët për në detyrë/atdhe më dt. 10 shtator 1636 me lejën e Kongregacionit të Shenjtë.

Këto vëzhgime paraprake lejohemi t'i mbyllim me një konstatim të fituar nga një kumt shtesë, të cilin e mësojmë nga kujtimet e Pjetër Bogdanit dora vetë, lidhur me qëndrimin e tij disavjeçar në atë kolegj (1647-1651), ku shkruan se i jepej rasti të çmallej çdo ditë me axhën e

---

*studiorum* të Urdhrit Jezuit; shih: <<https://portal.dnb.de/opac.htm?method=simpleSearch&query=4442482-6>>

<sup>11</sup> Arsi 229, fol. 4r: (teksti origjinal) <25 Martij Anni millesimi sexcen. triges. secundi Andreas Joannis Bogdani, Dieces. Priseren.>

<sup>12</sup> Viti 1607 është regjistruar edhe te Farlati & Coleti: *Illyricum sacrum*, bl. VIII 20.

vet, duke kundruar portretin e tij të varur në ambientet e Kolegjit.<sup>13</sup>

### 3. Aktiviteti klerikal i Ndre Bogdanit

Me kthimin e tij në dioqezën amë fillon edhe odisea e gjatë për më shumë se 40 vjet e Ndre Bogdanit, fillimisht si meshtar, pas gjasë në atë dioqezë e famulli ku lindi e u rrit edhe nipi i tij Pjetri, për të ngjitur më pas edhe shkallët e hierarkisë kishtare në dy njësi të mëdha administrative të Kishës Katolike Romake, siç ishin Kisha Metropolitane e Ohrit (1651 – 1656) e më pas Arqipeshkvia e Shkupit (1656 – 1677), kur i rënduar nga moshja e sidomos nga telashet, mundimet e përndjekjet që përjetoi gjatë përballjes me autoritetet vendore të Portës së Lartë u detyrua së fundi të kërkonte lirim nga ai funksion me lutjen që t'i bëhej vend të nipit, Pjetrit të Madh të Bogdanajve, i cili atëbotë drejtonte Ipeshkëvinë e Shkodrës. Falë kësaj marrëdhënieje të pazgjydhshme *axhë* : *nip* historia ekleziastike e trevave shqiptare gëzon informacion deri diku të kënaqshëm për stacionet kryesore në aktivitetin baritor të Ndre Bogdanit, një informacion ky që përcillet si i tillë edhe në kompendiumin kryesor të historisë ekleziastike të Ballkanit: *Illyricum Sacrum* (bl. VIII 20v.; 201vv.). Në shumësinë e këtij informacioni feksin sidomos si materiale burimore të dorës së parë: a) dy letra që Pjetër Bogdani i dërgon Kongregacionit në vitin 1650, duke dashur të nxisë me to përzgjedhjen e ungjit të vet në fronin e mbetur vakant të Kishës Metropolitane të Ohrit (Marlekaj 1989, 2008<sup>2</sup> 235v.: dok. I; 237v.: dok. II; Marquet 1996 68vv.); b) shkrimin e zgjeruar të natyrës nekrologjike (2 prill 1684 – shih §2), hedhur në letër prej të nipit, Pjetër Bogdanit, dhe firmosur prej tetë famullitarëve të Arqipeshkëvisë së Shkupit, që asistuan edhe gjatë bartjes së kufomës për në banesën e fundit (Marlekaj 1989, 2008<sup>2</sup> 621vv.: dok. XCV; Marquet 1996 426vv.); si edhe c) njoftimin e bërë nga kardinal Gualtieri mbi emërimin e tij si arqipeshkëv i Kishës Metropolitane të Ohrit. Bëjmë fjalë këtu për tekstin e fundit që përmyll veprën madhore të “Çetës së Profetëve”. (Pjetër Bogdani 1685: shih në shtojcë) Sigurisht, duke u fokusuar vetëm në këto burime dokumentare si edhe në portretizimin e tij në *Illyricum Sacrum*, lejohemi t'i përcjellim lexuesit sado përciptas me stil telegrafik, sa vijon:

- Ndre Bogdani kthehet në fund të vitit 1636 në vendlindje, në

<sup>13</sup> „[...] il ritratto del quale ad vivum si trova nel Collegio Illyrico di Loreto.“ (shih Marlekaj 2008<sup>2</sup> 24 – me tregues burimi dokumentar). Pa dashur gjithsesi t'i bashkohemi patjetër këtij pohimi të Pjetër Bogdanit, duke vënë dorën në zjarr, ia vlen të përmendet këtu se axha i vet nuk e gëzoi atë portret falë rezultateve të shkëlqyeshme në kolegj, por thjesht si ish-nxënës i atij kolegji që mundi të ngjiste shkallët e hierarkisë së Kishës Katolike në vendin e vet, ku - falë edhe ndërhyrjes së të nipit erdhi e na u emërua arqipeshkëv (1650/1). Shih Moroni 2010 179vv.



dioqezën amë të Prizrenit me funksionin e misionarit apostolik të Kongregacionit të Shenjtë, pasi kishte përfunduar pas gjase shkëlqyeshëm studimet e tij në Kolegjin Ilirik të Loreto-s dhe si i tillë ishte shuguruar prift po aty.

- Ndreu duhet të ketë misionuar fillimisht në vendlindje, të cilën për shkak të përndjekjeve të vazhdueshme nga autoritetet vendore u desh ta braktiste me lang e me plang, duke kërkuar e gjetur strehë në Arqipeshkvinë e Shkupit (Janjevë).
- Më 27 shkurt 1651 – falë edhe insistimit të të nipit, Pjetrit – Ndreu ngjitet në katedrën e arqipeshkvit të Kishës Metropolitane të Ohrit, i emëruar me breve të posaçme nga Papa Innocentius X. Këtë funksion do ta ushtrojë jo më larg se marsi i vitit 1656, ndër të tjera edhe për shkak të grindjeve të vazhdueshme për punë kufijsh administrative me ipeshkvin e Dioqezës së Prizrenit, Imz. Sojmirović-in.
- Në mars të vitit 1656 Ndreu transferohet në Arqipeshkëvinë Shkupit, si primat i saj, funksion ky qo do ta ushtrojë për më shumë se dy dhjetëvjeçarë, shi deri në vitin 1677, kur i pranohet së fundi lutja për lirim nga detyra për arsye moshe dhe i mposhtur përfundimisht nga sëmundjet, lodhja dhe përndjekjet e të pafeve. Kongregacioni i Shenjtë mbajti parasysht edhe lutjen e tij të dytë për t'iu dhënë çelësat e arqipeshkvisë, nipit të vet, Pjetrit, atëbotë ipeshkëv i Dioqezës së Shkodrës.
- Ndreu ndahet nga jeta më 23 dhjetor 1683, pasi është salbuar prej të nipit, Pjetrit, duke u përcjellë për në banesën e fundit me nderimet e rastit në Kishën e Shënkollit në Janjevë. (Shih në shtojcë.)
- Përshkrimi i detajuar në shkrimin nekrologjik të Pjetër Bogdanit (më 2 prill 1684) lidhur me do shenja të natyrës hyjnore që i paraprinë, përkatësisht pasuan vdekjen e të ungjit, si shembull i devotshëm për një lumnim ase shenjtërim të ardhshëm, nuk do të ketë suksesin e dëshiruar, edhe pse firmoset si i tillë nga tetë famullitarë të asaj arqipeshkëvie.

Vërtetësi mëtojnë gjithsesi faktet që tretjen e natyrshme të korpit të tij e shoqëruan me radhë: a) së pari tretja sa dhimbshëm, aq edhe kobshëm: “si krypa nd’ ujët” e gramatikës latinisht – shqip që na e la në dorëshkrim; e b) së dyti tretja në kohën tonë sa dhunshëm aq edhe turpshëm e emrit të tij, sikurse e gjithë asaj aradhe personalitetesh të historisë së kulturës shqiptare me zhgun e veladon të zi që vetëm do ta nderonin një Fjalor Enciklopedik Shqiptar, sidomos ribotimin e tij mjerman në plot tri vëllime (FESH Tiranë 2008/9<sup>2</sup>).

## **Bibliografi**

### **1. Burime**

ARSI – Archivio Romano della Società di Gesù (Roma)

ASPF – Archivio Storico de Propaganda Fide (Roma)

ASSC – Archivio Storico della Sacra Casa (Loreto)

### **2. Literaturë shkencore e cituar**

Bogdani, Pjetër – shih më poshtë Omari, Anila

Demiraj, Bardhyl

2016: *Damnatio memoriae vs. laudatio funebris* – dy shfaqje të ‘tranzicionit’ intelektual në Enciklopedinë Shqiptare, në: “Milosao” – Supplement i “Gazeta shqiptare” nr. 239 (26.06.2016), S. 1-5; und nr. 240 (03.07.2016), S. 2-5.

Farlati, Daniele & Coleti, Jacopo

1819: *Illyricum sacrum*, t. VIII. Venetiis.

Jurić, J. – Korade, Mijo

1983 *Iz arhivske gradje o ilirskom kolegiju u Loretu, parte II*, në: “Vrela i prinosi” nr. 14, f. 155-203.

Marlekaj, At Jak (Luigi)

2008 *Pietro Bogdani e l’Albania del suo tempo: con la riproduzione fotografica di centotrentadue documenti*. Liantonio, 1989.

Pjetër Bogdani e Shqipnia e kohës së tij: me riprodhim fotografik të 132 dokumentave Shkodër (përkthye, pajisë me shënime të veçanta dhe redaktue nga Willy Kamsi). Shkodër.

Marquet, Odette

1997 *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*. Shkodër.

MORONI, Marco

2010 *Il Collegio illirico e l’Albania*, në: Marco Moroni: *Tra le due sponde dell’Adriatico. Rapporti economici, culturali e devotionali in età moderna*, Napoli – Roma 2010, 159-195.

Omari, Anila

2005 *Pjetër Bogdani: Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve)*. Botim kritik. Përgatitur nga Anila Omari, Tiranë.

Shtojcë 1: Kumti i emërimt të Andrea Bogdanit si Arqipeshkëv i Shkupit

VENERABILI FRATRI  
ANDREÆ BOGDANO  
nuper Archiepiscopo Ocridan. in Ar-  
chiepiscopum Scupien. electo.  
ALEXANDER  
PAPA VII



Enerabilis Frater Salutem, & Apostolicam benedictionem. Alia Nos te à vinculo, quo Ecclesie Ocridan. cui tunc præeras, tenebaris de fratrum nostrorum consilio, & Apostolicæ potestatis plenitudine absolutum. Te ad Metropolitanam Ecclesiam Scupien. certo tunc expresso modo pastoris solatio destitutam de simili consilio Apostolicam auctoritatem transtulimus, præsciendo te illi in Archiepiscopum, & Pastorem, & successivè Pallium insigne ultimam plenitudinis Pontificalis officii nomine tuo à Nobis postulatum de corpore B. Petri sumptum per Venerabiles fratres Archiepiscopos Marcianopolitanum, & Ocridan. sub certis modo, & forma tunc expressis tibi auximus assignandum, prout in diuersis nostris sub plumbo desuper expeditis litteris plenius continetur. Cum autem sicut Nobis nuper exponi fecisti, præfati duo Marcianopolitan., & Ocridan. Archiepiscopi plurimum distent à Regno Seruie, in quo dicta Ecclesia Scupien. sita reperitur; cupiasque propterea tibi per Nos ut infra opportunè provideri. Nos indemnitati, commoditatique tuis in præmissis consultum esse cupientes, teque specialibus fauoribus, & gratijs prosequi volentes, & à quibusvis Excommunicationis, suspensionis, & interdicti, aliisque Ecclesiasticis Sententijs, Censuris, & penis à iure, vel ab homine, quauis occasione vel causa laijs, si quibus quomodolibet innodatus ex. ad effectum præsentium duntaxat consequen. Itarum serie absoluentes, & absolutum fore censentes Supplicationibus tuo nomine nobis super hoc humiliter porrectis inclinati; Tibi ut à Venerabili Fratre Episcopo Scutare. pallium prædictum seruata alias in reliquis omnibus prædictarum Litterarum formis tibi assignandum recipere, ac in eius manibus nostro, & S. R. E. nomine Fidelitatis debita solitum iuramentum prestare, ac professionem Fidei iuxta articulos pridem ab hac Sancta Sede propositos emittere, necnon ipsi Episcopo Scutare., ut illud tibi ut præfertur, tradere, necnon iuramentum, & professionem huiusmodi recipere, & licitè possitis, & valcatis, dictam auctoritatem tenore præsentium licentiam impartimur. Non obstantibus præmissis, ac omnibus, & singulis illis, quæ in dictis litteris concessa sunt, non obstat, cæterisque contrarijs quibuscunque. Volumus autem, quod iuramenti, quod præstabis, & professionis fidei, quam emittes, formas huiusmodi de verbo ad verbum per tuas patentes litteras tuo Sigillo munitas ad nos, & hanc Sanctam Sedem prædictam, quanto citius potueris, destinare procures. Dat. Romæ apud S. Petrum sub Annulo Piscatoris. Die xx i. Aprilis M. DC. LVI. Pontificatus Nostri Anno Secundo.

G. Gualterius.

Faksimile 1: marrë prej "Çetës së Profetëve ..." (1685 – faqe e fundit, e panumëruar)

VËLLAIT TË NDERUAR  
ANDRE BOGDANI  
Deri dje arqipeshkv i Ohrit,  
tani i zgjedhur arqipeshkv i Shkupit.

ALEKSANDËR  
P A P A VII

Vëlla i nderuar, shëndet e bekim apostolik. Ne të liruar nga detyra kur ti atëhere drejtoje kishën e Ohrit, detyrë që e more pas këshillës së vëllezërve tanë dhe në përputhje me dëshirën apostolike, dhe me të njëjtën këshillë e autoritet apostolik, të transferuam në kishën metropolitane të Shkupit, të mbetur pa bari, duke të vënë në krye të saj si arqipeshkv dhe prift, dhe pastaj ta sollëm për të ta vënë të fundmen stolë ceremoniale, të marrë nga trupi i Shën Pjetrit, të kërkuar prej nesh në emrin tënd, nëpërmjet vëllezërve të nderuar, arqipeshkvëve të Marcianopolit dhe të Ohrit, të shprehura ty në njëfarë mënyre dhe forme, siç thuhet më gjerësisht në letra të ndryshme dërguar nga ne të vulosura me plumb. Por siç na tregove tani së fundi, meqenëse dy të sipërthënëtarë arqipeshkvë të Marcianopolit e të Ohrit ndodhen mjaft larg mbretërisë së Serbisë, ku bën pjesë edhe e lartpërmendura kishë e Shkupit, për këtë arsye dëshiron që ne për ty të marrim masat e duhura si më poshtë. Ne, duke dashur që së pari të kihet në konsideratë shëndeti dhe mirëqenia jote dhe duke dashur të të pajisim me favore e me ndere të posaçme, dhe, në rast se ti rezulton në njëfarë mënyre i prekur nga dënime kishtarë që kanë të bëjnë me shkishërimin, pezullimin dhe ndalimin, si dhe me të tjera vendime kishtarë si censura dhe ndëshkime ligjore e fizike, që mund të jepen në ndonjë rast a për arsye të veçantë, për efekt të kësaj letre ne të lirojmë nga gjithë seria e këtyre dënimeve dhe mendojmë që të lirohesh nga këto për shkak të lutjeve që na janë drejtuar me shumë përlulësi në emrin tënd mbi këtë çështje. Kur të kesh marrë nga ati i nderuar, ipeshkvi i Shkodrës stolën e lartpërmendur, që në bazë të letërës së mësipërme t'ua caktua ty, dhe mbasi prej duarve të tij do të kesh bërë betimin e zakonshëm në emër të besnikërisë ndaj SRE, e mbasi në këtë mënyrë të kesh lëshuar deklaratën e besimit sipas artikujve të përcaktuar më parë nga Selia e Shenjtë, si dhe t'ia transmetosh edhe vetë ipeshkvit të Shkodrës, mbasi të kemi marrë betimin dhe deklaratën e mësipërme, ne japim leje që ju të mundni dhe të jeni në gjendje ta ushtroni këtë autoritet simbas përmbajtjes së kësaj letre. Asgjë nuk mund të ndalojë ato që janë thënë dhe janë akorduar në këtë letër, qoftë në tërësinë e tyre, qoftë në elemente të veçantë, prandaj dëshirojmë që formulën e betimit që do të japësh dhe të deklaratës së besimit që do të lëshosh, fjalë për fjalë të na i dërgosh, me një letër të hapur tënden të pajisur me vulë, sa më shpejt që të mundesh në Selinë e Shenjtë.

Shkruar në Romë, në Shën Pjetër nën unazën e Peshkatarit, në datën 22 prill 1656, në vitin e dytë të pontifikatit tonë.

G. Gualtierius.

Varianti i përkthyer shqip i faksimiles (lart): (Omari 2005 – faqe e fundit e panumëruar)

Shtojcë 2: Kunti i Pjetër Bogdanit mbi vdekjen e axhës së vet

*Eminentissimi e Reverendissimi Signori Signori miei Padroni  
Colendissimi*

*Andrea Bogdani, mio carissimo zio e Padrone, nato delli 1600, stato alunno del Collegio Illyrico di Loreto per spatio di otto anni. Ordinato Sacerdote dalli 1635, consecrato Arcivescovo della Chiesa Patriarchale di Ocrida delli 1650, transferito all'Arcivescovato di Scopia Metropoli di Servia delli 1656, renun-  
tiò per vechiaia e malatie l'Arcivescovato nella mia persona, all'ora Vescovo di Scuttari, delli 1676. Persona di grandissima semplicità e rettitudine, carrico di anni e meriti, alli 23 dicembre 1683, munito delli Santissimi Sacramenti, rese l'Anima al Creatore con la mia assistenza, e con pianto di tutta la Christianità per la perdita di un tanto loro bon Pastore et amabilissimo Padre spiri-  
tuale. Fu sepolto nella Chiesa di San Nicolò Protettore del luogo di Jagnevo, sotto la lapida, qual costituisce il secondo scalino dell'Altare. Per la sua grande bontà, ha lasciato grande concetto di santità et esempio a posterì, come devono governarsi nella Turchia. E con questo all'Eminenze Vostre bagio le Sacre porpore.*

*Delle Vostre Eminenze Reverendissime*

*Jagnevo li primo marzo 1684*

*Humilissimo Devotissimo et Obligatissimo Servitore perpetuo*

*P. B. Arcivescovo di Scopia*

APT SOCG, vol. 490 ff° 279r; 282v

Transkriptim i realizuar prej Marquet 1997 nr. 254, f. 426.